



# SPEKTAKLI I DREJTËSISË ME ARRESTIME

**(Analizë e shkurtër ligjore rreth trajtimit të rastit Haki Rugova nga organet e drejtësisë)**



Autorët: Gzim Shala dhe Driton Nocaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

*Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Tetor, 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

## **Përmbajtja**

1. Përmbledhje ekzekutive .....	4
2. Arrestimi i Kryetarit të Komunës së Istogut dhe dy zyrtarëve të tjerë .....	6
3. Siguria juridike lidhur me arrestimin .....	7
4. Cenimi i sigurisë juridike në rastin konkret .....	9
5. Qëndrimet e partisë në pushtet: Nga besimi i plotë tek shteti i kapur .....	12
6. Rekomandime .....	15

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Mbrëmjen e 9 tetorit 2020, me urdhër të Prokurorisë Themelore në Pejë janë vënë nën pranga Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, ish-nënkryetari i kësaj komune, Lulzim Blakaj dhe një zyrtar tjetër i Komunës së Istogut. Mbi bazën e kërkesës së Prokurorit të Shtetit, Gjykata Themelore në Pejë ka shqiptuar masën e arrestit shtëpiak ndaj Kryetarit të Komunës së Istogut dhe nënkryetarit të kësaj komune.

Paraprakisht, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vë theksin tek fakti se ky institut nuk paragjykon fajësinë apo pafajësinë e asnjërit prej zyrtarëve të përfshirë në këtë rast. Meritat e këtij rasti do të shqyrtohen në vijim të procedurës penale, ku për secilin zhvillim, IKD përmes platformës informuese “Betimi për Drejtësi” do të raportojë në kohë reale.

Por, në këtë rast, IKD vlerëson se arrestimi i Kryetarit të Komunës së Istogut, nënkryetarit dhe një zyrtari të kësaj komune, shkel sigurinë juridike të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe se ky arrestim, nuk është në përputhje me kushtet, natyrën dhe qëllimin e arrestimit, aspekte këto të përcaktuara në Kodin Nr. 04/L-123 e Procedurës Penale, Kushtetutën e Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky arrestim është bërë për një veprë penale, e cila dyshohet të jetë kryer në vitin 2018, dhe sipas informatave të dhëna nga mbrojtja, ky rast është i deponuar në Prokurorinë Themelore të Pejës që nga marsi i vitit 2020, derisa arrestimi ka ndodhur shtatë (7) muaj pas. Natyra e dispozitave që i referohen arrestimit dhe caktimit të masave të sigurisë ka të bëjë me rastet kur natyra e rastit kërkon një veprim me urgjencë, ku zhvillimi normal i procedurës penale do të rrezikonte gjykimin e drejtë.

Cenimi i sigurisë juridike të qytetarëve të Republikës së Kosovës konsiston në arrestimin dhe caktimin e masave të sigurisë ndaj qytetarëve duke mos u bazuar në kërkesat ligjore. Me këtë, hapja e dosjeve dhe aktivizimi i tyre me një urgjencë jo ligjore, në çfarë do kohe, është sinjal i Prokurorit të Shtetit se varësisht nga interesat e caktuara, në secilin rast mund të arrestojë secilin qytetar, dosja e të cilit është e deponuar në Prokurori. E gjithë kjo, më pas do të përkthehet në frikë ndaj sistemit të drejtësisë, dhe jo ndaj ligjit.

Në anën tjetër, Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherit ish-Kryeministër i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, në shumë raste kishte mbrojtur dhe përkrahur Kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi, nën dijeninë e të cilit është kryer edhe arrestimi i Kryetarit të Komunës së Istogut. Por, pas këtij arrestimi, Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka drejtuar akuza të forta ndaj Prokurorit të Shtetit, të cilat akuza konsistojnë në motivim politik të sistemit prokurorial me rastin e arrestimit të Kryetarit të Komunës së Istogut.

Për më tepër, gjatë konferencës për media të mbajtur më 11 tetor 2020, ish-Kryeministri Isa Mustafa, ka thënë se është njoftuar nga mbrojtësi i Kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, se i njëjti ka kërkuar që rasti të trajtohet nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, dhe që Prokuroria Speciale të merr në kompetencë këtë lëndë, duke shprehur besim se trajtimi i rastit të Rugovës nga Prokuroria Speciale do të bëhet si duhet dhe në bazë të ligjit.

Që nga fundi i vitit të kaluar, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës udhëhiqet nga Blerim Isufaj, i cili në të kaluarën, kishte qenë këshilltar i tani të ndjerës znj. Nekibe Kelmendi, ish-ministre e Drejtësisë nga radhët e LDK-së. Pra, kërkesa e Mustafës është që ky rast të trajtohet në prokurorinë me të cilën udhëheqë një person që në të kaluarën ka pasur afërsi me partinë në krye të së cilës është Mustafa.

Në këtë drejtim, arrestimi i Haki Rugovës, i cili vie nga radhët e LDK-së, shpërfaq mungesën e vullnetit politik për të depolitizuar sistemin e drejtësisë. Kjo për arsye se çdo depolitizim potencial i sistemit të drejtësisë, potencialisht prek edhe zyrtarë të partive të caktuara, dhe si i tillë, bazuar në këtë mënyrë të veprimit, nuk paraqet interes dhe as prioritet për figura të caktuara politike, në rastin konkret Kryetarit të partisë që udhëheq në nivel qendror.

## 2. Arrestimi i Kryetarit të Komunës së Istogut dhe dy zyrtarëve të tjerë

Mbrëmjen e 9 tetorit, me urdhëro të Prokurorisë Themelore në Pejë janë vënë nën pranga Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, ish-nënkryetari i kësaj komune, Lulzim Blakaj dhe një zyrtar tjetër i Komunës së Istogut.

Arrestimi i Kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, është bërë nën dyshimin për kryerje të veprës penale “Konflikt i interesit”, “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “falsifikimi i dokumentit zyrtar”, derisa arrestimi i ish-nënkryetarit të Komunës së Istogut, Lulzim Blakaj, është bërë nën dyshimin për kryerje të veprave penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Falsifikim i dokumentit zyrtar”. Ndërsa, zyrtari i Komunës së Istogut, F.B., është arrestuar nën dyshimin se në bashkëkryerje me Kryetarin dhe nënkryetarin e Komunës së Istogut, ka kryer veprën penale të “Falsifikimit të dokumentit zyrtar”.

Veprat penale, për të cilat dyshohet Kryetari, nënkryetari dhe zyrtari i Komunës së Istogut, dyshohet se janë kryer në prill të vitit 2018.

Pas arrestimit, Prokuroria Themelore në Pejë ka parashtruar në Gjykatën Themelore të Pejës kërkesë për caktimit e arrestit shtëpiak ndaj tre (3) të dyshuarve.

Seanca dëgjimore para gjyqtarës së procedurës paraprake është mbajtur më 11 tetor 2020, e cila seancë, është mbyllur për publikun, përkundër interesit të madh të publikut për këtë rast.

Gjatë kësaj seance, Prokurori i Shtetit ka hequr dorë nga kërkesa për caktimin e arrestit shtëpiak ndaj të dyshuarit F.B., zyrtar i Komunës së Istogut.

Pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore, përmes një komunikate për media, Gjykata Themelore në Pejë ka bërë të ditur se Departamenti për Krime të Rënda i kësaj gjykate e ka aprovuar propozimin e Prokurorisë Themelore në Pejë, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale “konflikt i interesit”, “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “falsifikim i dokumentit zyrtar”, si dhe ndaj ish-nënkryetarit Lulzim Blakaj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “falsifikim i dokumentit zyrtar”. Sipas kësaj komunikate, të njëjtëve u është caktuar masa e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej një muaji.

*“Gjyqtarja e procedurës paraprake pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe pas analizimit të shkresave të lëndës ka vërtetuar se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit H.R dhe L.B kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen nga ana e prokurorisë së shtetit, po ashtu ekzistojnë rrethanat që tregojnë rrezikun se me gjetjen e mundshme të pandehurve në liri mund të ndikojnë tek zyrtaret komunalë, por edhe tek dëshmitarët e tjerë në drejtim të fshehjes dhe ndryshimit të provave materiale e me këtë të pengojnë rrjedhën normale të procedurës penale. Gjithashtu, duke pas parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale dhe duke pas parasysh pasojat e rënda që kanë këto vepra penale për shoqërinë, përhapjen e tyre në masë shqetësuese si dhe faktin se i pandehuri H.R edhe më parë ka qenë i njohur për organet e drejtësisë për vepër penale konflikt interesi, tregojnë rrezikun*

*se me gjetjen e mundshme të të pandehurve në liri, të njëjtit mund të përsërisin veprat penale apo të kryejnë ndonjë veprë të re penale. Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe sipas propozimit të mbrojtësve që ndaj të mbrojturve të tyre të refuzohet propozimi për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, ka vlerësuar edhe masat e tjera por ka gjetur se masa e arrestit shtëpiak është masa më adekuate në këtë fazë të procedurës penale”, thuhet tutje në komunikatën për media të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë.*

### **3. Siguria juridike lidhur me arrestimin**

Rendi juridik kosovar ka inkorporuar në veten e saj standardet më të larta të sigurisë juridike të qytetarëve në secilën fushë, përfshirë edhe fushën e drejtësisë penale. Kjo, është bërë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të cilat të drejta dhe liri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë të përcaktuara si vlera.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale ka përcaktuar dispozitat që i referohen arrestimit të përkohshëm dhe ndalimit policor dhe arrestimit në fazën e hetimeve. Në rastin konkret, bëhet fjalë për arrestim në fazën e hetimeve.

Arrestimin gjatë fazës së hetimeve e rregullon neni 164 i këtij kodi, në të cilin përcaktohet se:

*“1. Kur prokurori i shtetit autorizon hetimin, policia arreston dhe ndalon personin vetëm nëse: 1.1. ka dyshim të bazuar se ai ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe 1.2. ka baza të artikulueshme për të besuar se: 1.2.1. ka rrezik të arratisjes; 1.2.2. ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose 1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej. 2. Arrestimi dhe ndalimi nga ky nen autorizohet nga prokurori i shtetit që ka filluar hetimin, ose kur për shkak të rrethanave të ngutshme autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit, nga policia e cila menjëherë pas arrestimit duhet të informojë prokurorin e shtetit. 3. Personi i arrestuar sipas këtij neni gëzon të drejtat e të pandehurit.”.*

Pra, sipas kësaj dispozite, arrestimi bëhet vetëm në rastet kur drejtësia dhe siguria rrezikohet nëse i pandehuri nuk arrestohet. Pra, jo në secilin rast të dyshimit për një veprë penale, i dyshuari duhet të arrestohet, por vetëm nëse plotësohen edhe kushtet e veçanta, siç janë rreziku i arratisjes, ndikimi në dëshmitarë apo prova dhe rreziku i përsëritjes/përfundimit të veprës penale.



Kritere të njëjta janë përcaktuar edhe për vijimësinë e procedurës paraprake. Për të kërkuar dhe shqiptuar masën e sigurisë së arrestit shtëpiak, krahas dyshimit të bazuar për kryerje të një veprë penale, kërkohet edhe plotësimi i këtyre tri (3) kritereve të veçanta. Neni 183 i Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale përcakton se:

*“Gjykata mund të caktojë arrestin shtëpiak për të pandehurin nëse: 1.2. plotësohen kushtet nga neni 187, paragrafi .1, nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi”* derisa në nenin 187.1.1.2 përcaktohen tri (3) kushtet e posaçme për shqiptimin e arrestit shtëpiak, e që janë:

*“1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethanat të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij; 1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose 1.2.3. kur peshat e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej”.*

Në anën tjetër, sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) është drejt për së drejti e zbatueshme në rendin juridik kosovar dhe në rast të konfliktit, ka epërsi ndaj ligjeve të tjera, derisa në përputhje me nenin 53 të kësaj kushtetute, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të interpretohen në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

E drejta për liri dhe siguri është e garantuar me nenin 5 të KEDNj-së, ku si rrethanë përjashtuese e kësaj të drejte, relevante për rastin konkret, është situata kur personi *“kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”*.

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, neni 5 i KEDNj-së si qëllim në thelb ka mbrojtjen e individit nga heqja arbitrare ose e papërligjurore e lirisë. *“E drejta për lirinë dhe për sigurinë personale ka një rëndësi shumë të madhe në një “shoqëri demokratike”, thuhet në një prej vendimeve të kësaj gjykate<sup>1</sup>.*

Në një rast tjetër, kjo gjykatë ka përcaktuar se *“për të përmbushur kërkesën për ligjshmëri, një ndalim duhet të bëhet “sipas procedurave të parashikuara me ligj”, çka do të thotë se ndalimi duhet të jetë në përputhje si me normat materiale ashtu edhe me ato procedurale të së drejtës së brendshme”<sup>2</sup>.*

<sup>1</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar. Paragrafi 30.

<sup>2</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Del Río Prada kundër Spanjës. Paragrafi 125.



Sa i përket seancës dëgjimore për caktimin e masës së sigurisë, GjEDNj në një rast tjetër ka përcaktuar se *“Seanca dëgjimore për shqyrtimin e kushteve dhe mënyrës së privimit të lirisë të personit duhet të kenë karakter gjyqësor dhe procedurat e zhvilluara sipas nenit 5 paragrafi 4 të Konventës duhet të përmbushin në masë të madhe, kërkesat bazë për një proces të rregullt, i cili duhet të jetë kontradiktor dhe të sigurojë barazinë e armëve ndërmjet palëve”*<sup>3</sup>.

Po ashtu, kjo Gjykatë ka përcaktuar edhe standardet e kërkuara për shqiptimin e një mase të sigurisë, ku ka nënvizuar se *“barra e provës i bie shtetit që të tregojë se një masë më pak shtrënguese ndaj ndalimit nuk do t'i shërbente qëllimit përkatës”*<sup>4</sup>, se *“vendimi për ndalimin duhet të jetë mjaftueshëm i arsyetuar dhe nuk duhet të përdorë forma stereotipe të formulimit”*<sup>5</sup>, dhe se *“Argumentet pro dhe kundër paraburgimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”*<sup>6</sup>.

#### **4. Cenimi i sigurisë juridike në rastin konkret**

Paraprakisht, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vë theksin tek fakti se ky institut nuk paragjykon fajësinë apo pafajësinë e asnjërit prej zyrtarëve të përfshirë në këtë rast. Meritat e këtij rasti do të shqyrtohen në vijim të procedurës penale, ku për secilin zhvillim, IKD përmes platformës informuese “Betimi për Drejtësi” do të raportojë në kohë reale.

Por, në këtë rast, IKD vlerëson se arrestimi i Kryetarit të Komunës së Istogut, nënkryetarit dhe një zyrtari të kësaj komune, shkel sigurinë juridike të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe se ky arrestim, nuk është në përputhje me kushtet, natyrën dhe qëllimin e arrestimit, aspekte këto të përcaktuara në Kodin Nr. 04/L-123 e Procedurës Penale, Kushtetutën e Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Fillimisht, duhet të vëmë theksin se rasti për të cilin dyshohen të pandehurit në këtë rast, është rast i cili dyshohet se ka ndodhur në vitin 2018. Veprat penale për të cilat të pandehurit janë të dyshuar në këtë rast, lidhen me vepra penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Për nga natyra e këtyre veprave penale, hetimi dhe provimi i këtyre veprave penale bëhet kryesisht përmes provave materiale, përkatësisht dokumenteve që dëshmojnë kundërligjshmërinë e veprimeve dhe dëmin e shkaktuar. Në rastin konkret, pasi bëhet fjalë për një rast të vitit 2018, provat materiale nga ky rast veçse janë gjeneruar.

Për më tepër, për aq sa ka dhënë informacion mbrojtja, prokuroria dhe gjykata, bëhet fjalë për vepra penale për të cilat prokuroria ka siguruar shkresat e lëndës apo provat materiale. Për më tepër, sipas këtyre burimeve, të njëjtat shkresa dhe prova, Prokuroria Themelore në Pejë i ka në posedim që nga marsi i vitit 2020.

<sup>3</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Nikolova kundër Bullgarisë. Paragrafi 58.

<sup>4</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Ilijkov kundër Bullgarisë. 26 korrik 2001. f. 85.

<sup>5</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Yagci dhe Sargin kundër Turqisë. 8 qershor 1995. f.52.

<sup>6</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Smirnova kundër Rusisë. 24 korrik 2003. f.63.

Në këtë mënyrë, arrestimi dhe mbajtja në arrest shtëpiak e Kryetarit dhe nënkryetarit të Komunës së Istogut nuk paraqet asnjë urgjencë, pasi bëhet fjalë për një rast të vitit 2018, provat e të cilit veçse janë gjeneruar, dhe të cilat prova PTh në Pejë i ka në dispozicion që nga marsi i vitit 2020.

Në këtë mënyrë, nëse do të paraqitej rreziku i ikjes, ndikimit në dëshmitar apo përsëritjes së kryerjes së veprës penale, Prokurori i Shtetit do të duhej të vepronte në momentin e parë kur ka pranuar informacionin, dhe jo pas disa muajve, përkatësisht pas disa viteve.

Madje, për aq sa është dhënë informacion, i gjithë narrativi ndërtohet për një vepër penale të vitit 2018, dhe të paktën që nga marsi i vitit 2020, nuk ka ndryshuar asgjë.

Sa i përket aktvendimit të gjykatës për caktimin e arrestit shtëpiak, ky vendim është në kundërshtim me ligjin dhe jurisprudencën e GjEDNj-së.

Sipas komunikatës për media të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, thuhet se: *“ekzistojnë rrethanat që tregojnë rrezikun se me gjetjen e mundshme të pandehurve në liri mund të ndikojnë tek zyrtaret Komunalë, por edhe tek dëshmitarët e tjerë në drejtim të fshehjes dhe ndryshimit të provave materiale e me këtë të pengojnë rrjedhën normale të procedurës penale”*. Shqiptimi i një mase të sigurisë përmes një arsytimi të tillë është rast tipik i asaj që GjEDNj ka theksuar se: *“Argumentet pro dhe kundër paraburgimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”<sup>7</sup>*.

Po ashtu, në komunikatës për media të Gjykatës Themelore në Pejë thuhet se: *“Gjithashtu, duke pas parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penal edhe duke pas parasysh pasojat e rënda që kanë këto vepra penale për shoqërinë, përhapjen e tyre në masë shqetësuese si dhe faktin se i pandehuri H.R edhe më parë ka qenë i njohur për organet e drejtësisë për vepër penale konflikt interesi, tregojnë rrezikun se me gjetjen e mundshme të të pandehurve në liri, të njëjtit mund të përsërisin veprat penale apo të kryejnë ndonjë vepër të re penale”*.

Fillimisht, kjo pjesë e komunikatës shkel parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit në procedurë penale, pasi paragjykon kryerjen e veprës penale, duke konsideruar *“rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale”*, dhe jo dyshimin për kryerje të veprës penale.

Ndërsa, pjesët e tjera të përmendura në këtë pjesë të komunikatës për media nuk kanë të bëjnë me caktimin e një mase të caktuar të sigurisë, por se të njëjtat janë aspekte që shqyrtohen me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, pasi i pandehuri shpallet fajtorë.

Po ashtu, në nenin 164 është përcaktuar se arrestimi gjatë fazës së hetimeve bëhet vetëm pasi Prokurori i Shtetit ka autorizuar hetimet, përkatësisht ka nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve.

---

<sup>7</sup> Po aty.

Në rastin konkret, arrestimi i të pandehurve është bërë më 9 tetor 2020, derisa sipas mbrojtjes, aktvendimi për fillimin e hetimeve është nxjerrë më 11 tetor 2020. Këtë fakt, nuk e ka demantuar as Prokuroria e as Gjykata Themelore në Pejë.

Me këtë rast, ky aspekt paraqet një shkelje të re, dhe e konteston në thelb ligjshmërinë e gjithë procedurës në këtë rast. Përkatësisht, në rastin konkret, bëhet fjalë për arrestim të kundërligjshëm.

Lidhur me këtë, siç u tha edhe më lartë, GjEDNj në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se *“për të përmbushur kërkesën për ligjshmëri, një ndalim duhet të bëhet “sipas procedurave të parashikuara me ligj”, çka do të thotë se ndalimi duhet të jetë në përputhje si me normat materiale ashtu edhe me ato procedurale të së drejtës së brendshme”*<sup>8</sup>.

Për më tepër, Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, pikërisht për vepër penale të konfliktit të interesit, ka edhe një aktakuzë tjetër aktive në Gjykatën Themelore të Pejës, për të cilin rast, Rugova asnjëherë nuk ishte ndaluar apo arrestuar<sup>9</sup>.

Me këtë rast, IKD vlerëson se mbi fatin e një rasti të vetëm, pa marrë parasysh se për cilin rast bëhet fjalë, me këtë mënyrë të veprimit rrezikohet siguria juridike e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për më tepër, ky cenim i sigurisë juridike bëhet pikërisht nga sistemi i drejtësisë, i cili sistem është sistemi më i thirrur për mbrojtjen e sigurisë juridike.

Cenimi i sigurisë juridike të qytetarëve të Republikës së Kosovës konsiston në arrestimin dhe caktimin e masave të sigurisë ndaj qytetarëve duke mos u bazuar në kërkesat ligjore. Me këtë, hapja e dosjeve dhe aktivizimi i tyre me një urgjencë jo ligjore, në çfarë do kohe, është sinjal i Prokurorit të Shtetit se varësisht interesa të caktuara, në secilin rast mund të arrestoj secilin qytetar.

E gjithë kjo, më pas do të përkthehet në frikë ndaj sistemit të drejtësisë, dhe jo ndaj ligjit.

Për këtë arsye, IKD konsideron se me qëllim të mbrojtjes së parimeve mbi të cilat ndërtohet rendi juridik kosovar, sistemi i drejtësisë në secilin rast të vepronë në përputhje me kërkesat ligjore, në atë mënyrë që Republika e Kosovës edhe në praktikë, krahas përcaktimeve në letër, të jetë një shtet ku sundon ligji.

Për më tepër, për praktika të kësaj natyre, buxhetit të Republikës së Kosovës deri më tani i janë shkaktuar dëme milionëshe, përmes kompensimit të personave, të cilët janë arrestuar, mbajtur në paraburgim, arrest shtëpiak apo vuajtje të dënimit pa bazë<sup>10</sup>.

---

<sup>8</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Del Río Prada kundër Spanjës. Paragrafi 125.

<sup>9</sup> "Sërish dështon gjykimi për konflikt interesi ndaj kryetarit të Istogut, Haki Rugova". Betimi për Drejtësi. 10 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-deshton-gjykimi-per-konflikt-interesi-ndaj-kryetarit-te-istogut-haki-rugova/>). (Qasur për herë të fundit më 11 tetor 2020).

<sup>10</sup> "Humbja e milionave nga “gabimet” e drejtësisë". Betimi për Drejtësi. 16 mars 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/humbja-e-milionave-nga-gabimet-e-drejtesise/>). (Qasur për herë të fundit më 11 tetor 2020).

## 5. Qëndrimet e partisë në pushtet: Nga besimi i plotë tek shteti i kapur

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, më 30 dhjetor 2015 kishte nxjerrë një udhëzim të detyrueshëm për të gjithë prokurorët, i cili siç thuhet në këtë udhëzim, është në funksion të qenurit në dijeni në raport me rastet penale të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike që kanë në punë të gjitha prokuroritë.

Ky udhëzim përcakton se *“I. Të gjithë prokurorët e shtetit obligohet, që brenda afatit prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e pranimit të: raportit, informatës, parashtrësës apo kallëzimit penal apo për ndonjë lëndë penale që aktualisht janë duke e trajtuar në fazën e procedurës paraprake penale, ose nën hetim për veprë penale të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike, që me arsye mund të besoj se ajo veprë penale të jetë kryer nga ndonjëri prej personave aktual në pozita të lartë udhëheqëse apo kanë qenë më parë në pozita të tilla si: Kryeministër, ministër, zëvendës ministër, deputet, prokuror, gjyqtar, sekretar permanent, drejtor i policisë, drejtor i doganave, drejtor i administratës tatimore, drejtora menaxhues të kompanive publike, drejtora menaxhues të gjitha agjencioneve të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe persona tjerë zyrtar në pozita të lartë udhëheqëse, që të informojnë kryeprokurorin e zyrës së tyre. II. Kryeprokurori i zyrës përkatëse, posa të pranoj informatën e tillë si në pikën I të këtij udhëzimi, brenda afatit prej tetë (8) ditësh, obligohet ta informoj Kryeprokurorin e Shtetit për rastin në fjalë”.*

Pra, bazuar në dispozitat e këtij udhëzimi, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka qenë paraprakisht i njoftuar lidhur me rastin konkret, për të cilin është arrestuar edhe Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, i cili vie nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arrestimin e Kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, dhe dyshimet që rëndojnë mbi të njëjtin, dega e LDK-së në Istog, përmes një komunikate për media i ka konsideruar tërësisht politike dyshimet e Prokurorisë. *“Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës, beson se ky ndalim është kryer me motive politike, prandaj ne besojmë në paanësinë e organeve të drejtësisë”*, thuhet ndër të tjera në deklaratë.

Po ashtu, në konferencën për media të mbajtur nga Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ky i fundit ka hedhur akuza ndaj sistemit prokurorial, se i njëjti është i motivuar politikisht, duke e cilësuar Kosovës si *“shtet i kapur”*.

Gjatë kësaj konference, Isa Mustafa ka thënë se partia e tij e përkrah drejtësinë e pavarur mirëpo sipas tij, ajo duhet të zbatohet sipas ligjit dhe Kushtetutës.

*“Një shtet i kapur krijon pasiguri tek qytetarët e Republikës së Kosovës sepse çdo qytetarë mund të frikësohet se një ditë mund të jetë viktimë e lidhjes së sistemit të drejtësisë me politikën apo me grupe të forta të interesit”*, ka deklaruar Mustafa.

Mustafa e ka konsideruar pa bazë ligjore arrestimin e kryetarit Rugova. Mustafa në emër të LDK-së kërkoi nga sistemi i drejtësisë që të zhvillohet proces i shpejt gjyqësor në mënyrë që të vërtetohet bazueshmëria apo pabazueshmëria e akuzave.

*“Nëse ky proces zhagitet, atëherë ne konsiderojmë se arrestimi i tij dhe denigrimi para opinionit si kryetar i Komunës, si nënkryetar i LDK-së dhe kryefamiljar është bërë me qëllime politike që ta dëmtojë atë personalisht dhe LDK-në”, ka thënë i pari i LDK-së.*

Sipas Mustafës me arrestim e Rugovës është tentuar të njolloset qeverisja pa afera korruptive e Qeverisë së Kosovës, duke shtuar se do të kërkohet llogari nga autoritetet përgjegjëse se mbi cilën bazë ligjore policia dhe prokuroria e kanë vënë nën arrest Rugovën, pasi sipas Mustafës të gjithë janë dëshmitar se Prokuroria nuk është duke i paraburgosur individët ndaj cilëve po zhvillohen hetime ndaj dhjetëra miliona euro.

*“Ne si LDK kërkojmë që sistemi i drejtësisë, policia, gjyqësia por edhe prokuroria të qëndrojnë larg politikës. Nëse prokurori apo prokurorja e merr rolin e diktimit të zgjedhjeve në Komunën e Istogut, Pejës ose diku tjetër, sepse është e lidhur me një parti politike, atëherë rrezikohet plotësisht demokracia në këtë vend”, ka përfunduar Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa.*

Mirëpo, Kryetari i LDK-së dhe ish-Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, i kishte dalë disa herë në mbrojtje Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili bazuar në udhëzimin e sipër cituar, ka qenë në dijeni për këtë rast.

Ish-kryeministri Isa Mustafa, si kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës(LDK) sipas prononcimeve për media të ndryshe, i ka dalë në mbrojtje disa herë, Kryeprokurorit të shtetit Aleksandër Lumezit. Ish- kryeministri Mustafa, kishte mbrojtur dhe mbështetur në disa ngjarje kryeprokurorin Lumezi, siç ishin dyshimet për falsifikim të provimit të Jurisprudencës dhe rastit për fryrjen e listave të veteranëve të rrejtshëm.

Dyshimet e ngritura ndaj Lumezit lidhur me vërtetësinë së provimit të jurisprudencës, Mustafa i kishte cilësuar si pjesë e fushatës ndaj institucionit të Prokurorit të Shtetit.

*“Në qoftë se dikush do ta ketë ditur se Kryeprokurori (nuk ka ?!) provim të jurisprudencës, do të tregonte me kohë, jo në momentin që është shpallur fajtor për një vepër që i është përshkruar. Organizimi i një “gjuetie” të tillë ndaj një institucioni për gjera të cilat mund të vërtetohen, duket se kalon arsyen e validitetit të një dokumenti. E gjithë kjo më shumë po përngjanë në një bashkërenditje për të dekurajuar punën e një institucioni tepër të rëndësishëm sesa për të sqaruar një çështje që sqarohet”, kishte shkruar Mustafa në rrjetin social facebook në vitin 2017.*

Po ashtu, Isa Mustafa kishte mbështetur kryeprokurorin Lumezi edhe në rastin e fryrjes së listave të veteranëve. Në 22 gusht të vitit 2018, Mustafa përmes postimit në rrjetin social facebook kishte kërkuar sjellje racionale sepse Kryeprokurori dhe as prokurori i lëndës nuk i kishin fryrë listat

*“Shteti i Kosovës duhet të gjejë rrugë për tejkalimin e deformimeve me listat e veteranëve dhe përfitimet e pamerituara të një pjese të tyre. Këtë problem e kemi diskutuar disa herë me përfaqësuesit e FMN-së sa isha Kryeministër i vendit, dhe ishim në një rrugë të gjejmë zgjidhje nga ekspertiza dhe përvoja e tyre ndërkombëtare. Si i tillë, ekzagjerimi i listave dhe numrit të*

*veteranëve nuk duhet të jetë vetëm çështje e prokurorisë dhe gjyqësisë, edhe pse këto organe duhet të vazhdojnë pa presione ta bëjnë punën e tyre. Gjeneza, mendoj se, qëndron te lëshimi me prapavijë klienteliste apo edhe nga interesa të tjera e dëshmime nga përgjegjësit e zonave për njerëz që nuk kanë qenë pjesë aktive e luftës. Prandaj duhet të sillemi racionalist, të mos ngatërrojmë adresat, sepse as Kryeprokurori dhe as ish prokurori i lëndë nuk i kanë fryrë listat. Shfryrja e listave duhet të ndodhë nga ata që i kanë fryrë dhe me Ligj të veçantë. Ndërkaq, keqpërdoruesit duhet të përgjigjen”, kishte shkruar Mustafa në llogarinë e tij në facebook.*

Po ashtu, Kreu i LDK-së, Isa Mustafa gjatë kohës sa kishte qenë kryeministër në prill të vitit 2015, kishte vizituar zyrtarisht Kryeprokurorin Aleksandër Lumezi të cilit i'a kishte uruar zgjedhjen në këtë detyrë dhe sipas komunikatës zyrtare të Kryeministrit, Kryeprokurori Lumezi kishte marrë përkrahje nga ish-kryeministri Mustafa duke inkurajuar që të punojë pa ndikime politike.

*“Natyrisht është një detyrë me përgjegjësi të lartë dhe një detyrë e rëndë, por kemi besimin e plotë se do të kryhet me sukses. I premtova po ashtu që ne si Qeveri do të ndërmarrim çdo gjë që të krijojmë kushtet për të cilat ne kemi përgjegjësinë ligjore dhe kushtetuese për funksionimin e Prokurorisë dhe organeve tjera të drejtësisë dhe se do të japim përkrahjen maksimale, gjithmonë duke u ruajtur nga ndërhyrja dhe nga infiltrimi politik. Dëshirojmë të përsërisim vendosmërinë që këto organe të jenë të pavarura tërësisht, dhe që së bashku të realizojmë detyrat tona sa i përket zhvillimit ekonomik, forcimit të shtetit ligjor dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”, kishte thënë ish-kryeministri dhe Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa.*

Ky ndryshim i qëndrimeve të kreut të partisë që qeverisë në nivel qëndron, paraqet një mos konsistencë në drejtim të vlerësimit dhe kritikimit të Prokurorit të Shtetit.

Përkatësisht, ndryshimi i tillë i qëndrimeve nënkupton faktin se një institucion duhet të vlerësohet dhe duhet të përkrahët, vetëm kur nuk ndërmerr veprime hetimore në drejtim të partisë nga e cila vjen një figurë e caktuar politika, derisa institucioni i njëjtë duhet të cilësohet si i kapur dhe i motivuar politikisht, nëse ndërmarrë veprime ndaj zyrtarëve të partisë ku bënë pjesë një figurë e caktuar politike.

Për më tepër, krahas kësaj mos konsistence, qëndrime të tilla të motivuara nga politikat ditore shpërfaqin mungesën e vullnetit politik për të krijuar depolitizim në sistemin e drejtësisë. Kjo për arsye se çdo depolitizim potencial i sistemit të drejtësisë, potencialisht prek edhe zyrtarë të partive të caktuara, dhe si i tillë, bazuar në këtë mënyrë të veprimit, nuk paraqet interes dhe as prioritet për figura të caktuara politike, në rastin konkret Kryetarit të partisë që udhëheq në nivel qëndron.

Në anën tjetër, gjatë konferencës për media të mbajtur më 11 tetor 2020, Ish-Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se është njoftuar nga mbrojtësi i Kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, se i njëjti ka kërkuar që rasti të trajtohet nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, dhe që Prokuroria Speciale të merr

në kompetencë këtë lëndë, duke shprehur besim se trajtimi i rastit të Rugovës nga Prokuroria Speciale do të bëhet si duhet dhe në bazë të ligjit.

Që nga fundi i vitit të kaluar, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës udhëhiqet nga Blerim Isufaj, i cili në të kaluarën, kishte qenë këshilltar i tani të ndjerës znj. Nekibe Kelmendi, ish-ministre e Drejtësisë nga radhët e LDK-së.

Pra, kërkesa e Mustafës është që ky rast të trajtohet në prokurorinë me të cilën udhëheqë një person që në të kaluarën ka pasur afërsi me partinë në krye të së cilës është Mustafa.

## **6. Rekomandime**

1. Institucionet e sistemit të drejtësisë të kujdesen që secili veprim procedural të ndërmerret në përputhje me ligjin.
2. Institucionet e sistemit të drejtësisë të kujdesen që të mos cenojnë sigurinë juridike të qytetarëve në asnjë rast.
3. Mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies brenda sistemit të drejtësisë, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të analizuar veprimet e ndërmarra në këtë rast dhe raste të ngjashme, në mënyrë që të rritet llogaridhënia e bartësve të funksioneve në sistemin prokurorial dhe gjyqësor me qëllim që të ruhet siguria juridike e qytetareve.
4. Politika të qëndroj larg ndikimit në proceset hetimore dhe gjyqësore, në të cilat subjekt të procedurave janë zyrtarët e partive, institucioneve apo familjareve të tyre.
5. Figurat e larta politike të dëshmojnë vullnet të mjaftueshëm për depolitizim të sistemit të drejtësisë.